

# **PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)**

## **HISTORIKU**

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) është një parti politike, e cila është themeluar në vitin 1992. Ajo përfaqëson minoritetet e Shqipërisë kryesisht minoritetin grek, dhe është vazhdimi politik i shoqatës *Omonia*. Kjo shoqatë u krijua menjëherë pas rënies së regjimit diktatorial në Shqipëri. Fillimisht u themelua në fshatin Dervişan më datë 11.01. 1991 me emërtimin Bashkimi Demokrat i Minoritetit Kombëtar Grek ose thënë ndryshe shoqata 'Omonia', e cila kishte për qëllim kryesor sigurimin e të drejtave të njeriut sipas principeve të deklaratës së Helsinkit dhe atyre të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Omonia ishte një organizatë kombëtare, politike, kulturore dhe që nxiste organizimin social. Sipas qëllimeve të saj të themelimit, anëtarët e Omonia-s luftonin për konsolidimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe të garantoheshin ruajtja e të gjitha të drejtave e të njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Mbi të gjitha, Omonia kërkonte që të siguronte që të gjitha të drejtat e njeriut të nënshkruara në konventat ndërkombëtare, institucionet e BE-së dhe në kushtetutën shqiptare të respektoheshin. Nga kjo shoqatë lindi Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) e cila e përkufizonte veten e saj si një parti social-liberale në mbështetje të minoritetit grek. Në zgjedhjet e para parlamentare të 31 marsit 1991, kjo parti nuk ekzistonte, kështu që në zgjedhje mori pjesë shoqata Omonia, e cila fitoi 5 deputetë. Dispozitat e reja kushtetuese të Shqipërisë, në verë të vitit 1991, ndaluan ekzistencën e partive me baza etnike dhe fetare dhe kjo gjë çoi në krijimin e PBDNJ. Ajo do të drejtohej nga Vasil Melo, një disident antikomunist, dhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 1992, kjo parti fitoi 2.7% të votave duke fituar dy deputetë, por sidoqoftë rezultatet u kontestuan nga PBDNJ. Në zgjedhjet e vitit 1996, PBDNJ u rrit duke fituar 4% të votave të përgjithshme, të cilat konvertoheshin në tre deputetë. Megjithëse gjatë zgjedhjeve parlamentare të parakohshme të vitit 1997, përqindja e votave të PBDNJ ra në 3.2 %, ata arritën që të siguronin katër mandate deputetësh në Kuvendin e Shqipërisë. Në vitin 2002 kryetar i PBDNJ zgjidhet Vangjel Dule. Megjithëse morën më shumë vota gjatë zgjedhjeve elektorale të vitit 2005, sistemi elektoral rajonal e reduktoi numrin e deputetëve të tyre në 2 vende. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2009 dhe 2013, PBDNJ arriti që të kishte vetëm një deputet, megjithëse në zgjedhjet e vitit 2013 ishte në koalicion me Partinë Socialiste. Gjatë vitit 2014, PBDNJ ishte e përfaqësuar nga tre zëvendësministra në qeverinë Rama I, por për shkak të konfliktit për reformën territoriale, doli në opozitë duke i larguar përfaqësuesit e saj nga qeverisja. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 ajo i bashkoi forcat me Partinë Demokratike duke fituar dy mandate deputetësh: një në Korçë dhe tjetri në Vlorë. Në aleancë me PD-në dhe LSI, PBDNJ dogji mandatet e deputetëve gjatë vitit 2018 dhe nuk mori pjesë në zgjedhjet vendore të vitit 2019.

## **KRYETARI - VANGJEL DULE**

### **JETËSHKRIMI**

Vangjel Dule lindi në Gjirokastrë në vitin 1968 dhe është kryetar i PBDNJ duke filluar nga viti 2002. Dule ka studiuar në degën e gjuhën angleze në Universitetin e Tiranës dhe e ka nisur karrierën e tij politike në qytetin e Vlorës, duke shërbyer si përfaqësues i qeverisë shqiptare në prefekturën e Vlorës. Nga viti 2002 ai ka qenë rregullisht deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe gjatë legjislaturave 2002 -2006 dhe 2007 – 2010 ka qenë anëtar i asamblesë parlamentare të Këshillit të Evropës.